

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Asllan Krasniqi duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditësit N.T.SH E. me seli në G., ndaj palës së paditur Ujësjiellësi Rajonal P.1 me seli në P.2, në praninë e të të autorizuarëve të palëve ndërgjyqëse (të të autorizuarit me shkrim avokatit H.K. nga G. i cili e përfaqësoj palën paditëse dhe të të autorizuarit me shkrim A.M. i cili e përfaqësoj palën e paditur), lidhur me kompensimin e dëmit material në shumën e përgjithshme prej; 12.819,00 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës; 26.10.2016, ndërsa pas marrjes së fjalës përfundimtare të hartuar me shkrim nga palët ndërgjyqëse, me datën; 07.11.2016 merr këtë:

### A K T G J Y K I M

Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.SH E. me seli në G..

I. Detyrohet pala e paditur Ujësjiellësi Rajonal P.1 me seli në P.2, që ti paguaj shumën e përgjithshme prej; 12.819,00 euro (dymbëdhjetëmijë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë euro) palës paditëse, dhe atë në emër të shpërblimit të dëmit material si në vijim; në emër të dëmtimit të pajisjeve elektike shumën prej 10.529,00 euro, ndërsa në emër të dëmtimit të objektit afarist shumën prej; 2.290,00 euro, me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar nga data e shkaktimit të dëmit me datën; 28.05.2013 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin parativ prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II. Detyrohet e pala e paditur ti paguaj shumën prej 2.292,00 euro (dymijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy euro) palës paditëse në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, poashtu pas pranimi të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

### A r s y e t i m

Paditësi N.T.SH E. me seli në G., fillimisht me datën; 07.06.2013 ka parashtruar pranë kësaj gjykate kërkesën për sigurimin e provës, ndërsa me datën; 08.07.2016 ka parashtruar padinë lidhur me kompenzimin e dëmit material në shumën e përgjithshme prej; 4.900,00 euro, ndaj palës së paditur Ujësjiellësi Rajonal P.1 me seli në P.2, duke kërkuar nga gjykata aprovimin e saj në tërësi si të bazuar, si dhe kompenzimin e shpenzimeve të procedurës, pas administrimit të të gjitha provave relevante të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Gjykata ka bërë shqyrtimin paraprak të padisë duke vlerësuar dhe konstatuar se kjo gjykatë ka kompetencë lëndore të zgjidhjes së kësaj çështje juridike, duke iu referuar dispozitave të nenit 29 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës përkatësisht dispozitave të nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat e Kosovës.

Gjykata me datën;05.07.2013 ka dal në vendin ku është shkaktuar dëmi për të bërë sigurimin e provës duke vepruar sipas kërkesës së palës paditëse,në prezencë të pronarit të palës paditëse Sh. B.,të të autorizuarëve të palës së paditur;A.M. dhe I.Xh.,si dhe në prezencë të ekspertit të elektroteknikës H.K. dhe ekspertit të ndërtimtarisë Sh.Q.,duke bërë shikimin vizuel nga vet gjyqtari i çështjes,si dhe duke autorizuar ekspertët lartëcekur për të vërtetuar dëmet e shkaktuara.

I autorizuari i palës paditëse si në seancën përgatitore,në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën e tij përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë precizimit të kërkesëpadisë duke kërkuar nga gjykata aprovimin e saj pasi që janë plotësuar të gjitha pretendimet të cilat janë të parapara me dispozitat ligjore të LMD-së,si dhe lidhur me aprovimin e normës së kamatës ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e shkaktimit të dëmit të datës;28.05.2013 e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës kontestimore pala paditëse i ka kërkuar dhe i ka specifikuar në fjalën e tij përfundimtare.

I autorizuari i palës së paditur ka mbetur në tërësi pranë pretendimeve të tija që nga seanca përgatitore dhe nga seancat e mbajtura pranë kësaj gjykate e poashtu edhe në fjalën e tij përfundimtare e ka kontestuar kërkesëpadinë e palës paditëse që ndërlidhet me bazën juridike dhe lartësinë e dëmit të kërkuar nga pala paditëse duke i propozuar gjykatës të vendos në mënyrë meritorë pas analizimit të të gjitha provave materiale.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka cekur.

Objekt shqyrtimi i kësaj çështje juridike është pretendimi i palës paditëse lidhur me kompensimin e dëmit material që rrjedh nga shpërthimi i gypit të ujësjellësit me datën;28.05.2013 që menaxhohet nga Ujësjellësi Rajonal P.1 me seli në P.2,me ç’rast palës paditëse N.T.SH E. në lokalit e tij afarist i cili gjindet në fshatin B. të F.K. i është shkaktuar dëm material në shumë të përgjithshme prej;12.819,00 euro (pas precizimit të kërkesëpadisë së paditësit),prej të cilave shuma prej;10.529,00 euro në emër të dëmtimit total të pajisjeve elektike,si dhe shumën prej;2.290,00 euro në emër të dëmtimit të lokalit afarist të paditësit.

Me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së palës paditëse gjykata paraprakishtë ka vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit duke iu referuar dispozitës së nenit 136 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së,në të cilën dispozitë në mënyrë shprehimore në paragrafin 1 të këtij neni se thuhet se”kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij,ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni thuhet se “për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji”.Në rastin konkret janë përmbushur në mënyrë kumulative të dy kushtet e cituara nga paragrafët e lartëcekur pasiqë nga gypi i ujësjellësit që ka shpërthyer me datën;28.05.2013 dhe ka shkaktuar dëmin material në lokalit afarist të palës paditëse ka qenë nën menaxhimin e palës së paditur,që do të thotë me fajin e palës së paditur poashtu është shkaktuar rrezik i shtuar i dëmit edhe për rrethin.

Ndërsa lidhur me lartësinë e dëmit të shkaktuar palës paditëse në lokalën e tij afarist, gjykata është bazuar në tërësi në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve të elektroteknikës Xh.S. dhe të ndërtimtarisë K.M. të cilët kanë hartuar në formën me shkrim dhe kanë sqaruar në seancën e mbajtur me datën;26.10.2016, duke mbetur pranë thënjeve të cituara se pasojat e dëmtimit të pajisjeve elektrike dhe objektit afarist kanë qenë nga rrjedhja e ujit të gypit të shpërthyer që ka vërshyer në lokalën afarist të paditësit.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me çmuarjen e të gjitha provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse është bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të LPK-së. ndërsa për pagesën e shumës në të holla në afatit parativ prej shtatë ditëve, që rrjedh nga dispozitivi i këtij aktgjykimi gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 509 pika e të LPK-së, ndërsa lidhur me llogaritjen e normës së kamatës ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke aprovuar kamatën ligjore prej 8 % nga dita e shkaktimit të dëmit të datës;28.05.2013 e deri në pagesën definitive duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Duke vendosur lidhur me detyrimin e palës së paditur për pagesën e shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumë prej;2.292,00 euro, gjykata është bazuar në dispozitën e nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, duke aprovuar shumën e lartëcekur si në vijim; në emër të taksës gjyqësore shumë prej;47,00 euro, për hartimin e padisë shumë prej;104,00 euro, në emër të hartimit të parashtrësës për sigurimin e provës shumë prej;50,00 euro, për katër përfaqësime gjatë vitit 2014 shumë prej;540,00 euro (135x4), për pesë përfaqësime gjatë vitit 2015 dhe 2016 shumë prej;1350,00 euro (270x5), shumë prej 201,00 euro në emër të hartimit të ekspertizës së elektroteknikës, ndërsa refuzohet shuma prej;301,00 euro në emër të pagesës për ekspertizë të deponuar në KGJK-së, si dhe shuma prej;100,00 euro në emër të hartimit të kërkesëpadisë, pasi që të njëjtat nuk kanë qenë detyrim i palës paditëse dhe nuk ka patur detyrim nga gjykata.

Pas analizimit dhe shtjellimit të kësaj çështje juridike gjykata ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitat e nenit 135 paragrafi 1 dhe 2, nenit 382 të LMD-së, si dhe në dispozitat e nenit 143 paragrafi 1 të LPK-së.

#### GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

-Departamenti për Çështje Ekonomike-  
C.nr.284/2013, me dt;07.11.2016

Gjyqtari;  
Asllan Krasniqi

**UDHËZIME JURIDIKE:** Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimit të tij duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.